



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 19.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi, në parim, i defisitit buxhetor dhe borxhit publik të projektbuxhetit për vitin 2020
2. **Marrin pjesë:**
3. Arben Ahmetaj, Arben Elezi, , Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Reme Lala, Eljo Hysko, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Krenar Ryçi, Suzana Topi, Ardit Konomi
4. **Mungojnë:**
Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Ylli Shehu, Blerina Gjylameti, Artur Roshi, Korab Lita,

Të Ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Anila Denaj, Ministre
Z. Endrit Lami Drejtor,
Znj. Belina Memeti, Pergjegjese sektori, drejtorja e Huamrrjes,
Z. Marjus Borokoci, Pergjegjese sektori, drejtorja e strategjise se riskut.

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Sot në rendin e ditës kemi diskutimin në parim të deficitit buxhetor dhe borxhit publik të projektbuxhetit për vitin 2020.

Të ftuar në komision janë ministrja për Financat dhe Ekonominë, zonja Anila Denaj, zoti Endrit Lami, drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zonja Belina Memeti, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Huamarrjes në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Marjus Borokoçi, përgjegjës sektori, Drejtoria e Strategjisë së Riskut në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Fjala për ju zonja ministre.

Anila Denaj – Niveli i borxhit i qeverisjes qendrore në raport me produktin e brendshëm bruto ka hyrë në një trajektore rënëse që prej vitit 2016. Vlerësimet për fundin e vitit 2019 tregojnë një rënie me rreth 2,5 pikë përqindje të borxhit të qeverisjes vendore në raport me produktin e brendshëm bruto. Në paralel me trajektoren rënëse të borxhit edhe deficitin buxhetor ka rënë në nivelin 2%, konkretisht në vitin 2019 me 1,9% ndaj produktit të brendshëm bruto. Më lejoni t'ju ritheksoj se në vitin 2020 parashikohet të jetë në nivelin 1,6%.

Huamarrja u është përgjigjur nevojave buxhetore, duke mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e deficitit të planifikuar. Nevojat për huamarrje kanë shënuar një rënie graduale, duke reflektuar përmirësimin e profilit të borxhit dhe reduktimin e riskut fiskal të qeverisë. Gjatë 5-vjeçarit të fundit burimet e brendshme të financimit kanë mbajtur peshën kryesore në mbulimin e nevojave për huamarrje në terma bruto, megjithatë gjatë viteve të fundit ka spikatur roli i huamarrjes nga jashtë në funksion të mirëmenaxhimit të likuiditetit dhe shlyerjes së detyrimeve të borxhit në valutë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Kjo mënyrë huamarrje u dedikua nga rënia e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare, si dhe nga kushtet e favorshme të financimit nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Zhvillimin kryesor në këtë aspekt e ka mbajtur emetimi i Eurobondit në shumën e 500 milionë eurove në fund të vitit 2018, i cili u shoqërua me procesin e parablerjes së pjesshme, *pay back*, të Eurobondit ekzistues në vlerën e 200 milionë eurove. Ky proces mundësoi jo vetëm plotësimin e nevojave për likuiditet të vitit 2018-2019, por edhe menaxhimin aktiv të detyrimeve të borxhit, duke mbajtur nën kontroll riskun e rifinancimit dhe atë të normave të interesit në periudhë afatmesme.

Objektivat strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit përgjithësisht janë përmbushur si në drejtim të arritjes së raporteve optimale ndërmjet kostove dhe risqeve, ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Ekspozimi më i ulët ndaj risqeve është arritur kryesisht

nëpërmjet përqendrimit më të lartë të huamarrja e brendshme të titujt afatgjatë, të cilat kanë mundësuar zgjatjen e jetëgjatësisë së borxhit me rreth 6 muaj në harkun kohor të 5 vjetëve. Nga ana tjetër rënia e normave të interesit shoqëruar me përdorimin më të lartë të burimeve të huaja të financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe ka ndikuar në optimizmin e kostos së përgjithshme të huamarrjes. Në këtë aspekt vlen të përmendet se gjatë viteve të fundit kostoja mesatare e borxhit është ulur ndjeshëm, pavarësisht rritjes së stokut të borxhit afatgjatë në portofol.

Në funksion të arritjes së objektivit për përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut sekondar janë ndjekur hapat e nevojshëm që kanë synuar rritjen e eficiencës, likuiditetit dhe të transparencës. Në këtë drejtim vlen të përmendet zbatimi i projektit pilot për emetimin e obligacioneve referencë, i cili ka filluar me obligacionin 5-vjeçar gjatë vitit 2018 dhe është shtrirë edhe në obligacion 3-vjeçar gjatë vitit 2019. Nga ana tjetër baza e investitorëve për titujt shtetërorë, megjithëse mbetet jo shumë e diversifikuar, e përqendruar kryesisht te sektori bankar, ka shfaqur një shtrirje më të gjerë drejt institucioneve jofinanciare, jo banka, si dhe drejt individëve.

Cilat janë perspektivat afatmesme? Pavarësisht progresit në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve gjatë viteve të fundit, vitit të ardhshëm, kryesisht në periudhën afatmesme do të vijohet me aktivitete, të cilat kanë si objektiv reduktimin e mëtejshëm të riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit, të borxhit të brendshëm. Në këtë drejtim prioritet do të mbetet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit nëpërmjet uljes së mëtejshme të përqendrimit të titujve afatshkurtër në portofol.

Niveli i financimit të brendshëm do të synohet të mbahet i qëndrueshëm, duke mos tejkaluar kapacitetet optimale të tregut. Nëpërmjet titujve afatshkurtër, kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues që maturohen, menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet, si dhe përmirësimi i portofolit vjetor të maturiteteve, ndërkohë që nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit.

Në periudhën afatmesme huamarrja e huaj planifikohet të mbulojë mesatarisht deri në 20% të nevojave të përgjithshme për hua të qeverisë dhe do të mbështetet kryesisht në huatë me terma pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare, huatë me terma të buta të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikat zhvillimore dhe reformat e ndërmarra nga qeveria, si dhe instrumentet financiarë të tregjeve të kapitalit Eurobond.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendas dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetëror, gjithashtu do të vijojë të mbetet objektiv parësor i strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit. Realizimi i suksesshëm i këtij objekti do të pasojë me kosto dhe risqe më të ulëta për të gjithë sektorët e tregut, duke përfshirë qeverinë, si dhe investitorët e titujve shtetërorë. Procesi, gjatë të cilit do të synohet të përmbushet ky objektiv, do të shtrihet në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, pasi sigurisht kalon në disa procese, të cilat janë të rëndësishme, por edhe sfiduese. Zhvillimi i kurbës së illdeve në drejtim të titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë nëpërmjet krijimit dhe konsolidimit të madhësive *Benchmark*, si dhe reduktimit të fragmentit të kërkesës është objektiv prima; përshtatja e politikës së huamarrjes përfshirë shitjen, pra blerjen dhe shkëmbimin e titujve shtetërorë në kushtet e tregut dhe kërkesës për tituj të caktuar; përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator për emetimin e titujve shtetërorë. Megjithatë, mendojmë që ky është një proces afatmesëm, siç e thashë edhe pak më parë, që do të kërkojë përfshirjen e shumë aktorëve për ta realizuar 2 apo 3 vjetët e ardhshëm.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A ka pyetje për ministren?

Po, Suzana.

Suzana Topi – Faleminderit!

Sipas raportit të projektbuxhetit borxhi publik do të ulet nga 64% në 62,2%, neto. A janë përfshirë këtu kostot e PPP-ve që shkojnë për kontratat, detyrimet që ka qeveria nga gjykatat brenda dhe jashtë vendit si dhe detyrimet e tjera tatimore?

Arben Ahmetaj – Fjala për ju, zonja Ministre.

Anila Denaj – Siç e kam theksuar në disa nga referencat të gjitha detyrimet kontraktuale janë të përfshira.

Arben Ahmetaj – Më falni, cila ishte përgjigjja?

(Diskutime pa mikrofon)

Cilat detyrime aktuale?

Anila Denaj – Të gjitha detyrimet kontraktuale që ka qeveria shqiptare, përfshi edhe detyrimet me mbulim të kostove buxhetore për PPP-të janë të përfshira në përlllogaritje.

Arben Ahmetaj – Jo të borxhit?

Suzana, jo të borxhit, të treguesve, ka një diferencë. PPP-të nuk janë borxh, praktikisht janë detyrime, të cilat prezantohen ose reflektohen në fiskale vit pas viti kur maturohen.

Pra, ka një mënyrë tjetër kontabiliteti për PPP-të, e cila varet nga logjika e riskut. Në vitin 1995 apo në vitin 2010 kemi, Marius?

(Diskutime pa mikrofon)

Në vitin 1995, apo jo?

Zonja Ministre, jo brenda borxhit, por brenda tabelës.

Dakord Suzana?

Faleminderit!

Grua – Meqenëse jemi këtu, unë po vazhdoj pyetjen e Suzanës. Mbetem te gjetja e KLSH –së në raportin që la për buxhetin e vitit 2018, ku specifikisht thuhej se deficitit buxhetor, sipas KLSH-së, nëse do të përfshihen detyrimet e prapambetura, është 2,2, pra e kalon limitin ligjor dhe rekomandonte përfshirjen. Pra, KLSH-ja flet për detyrime të prapambetura të papërfshira në treguesit makrofiskalë për një deficit buxhetor më të lartë, sepse sipas KLSH-së në vitin 2018 ishte 2,2, jo 1,9, a nuk e di tani, sa ishte. A është marrë parasysh? A kemi ndonjë ndryshim? A ka ndonjë të re në plotësim të kushteve ose të kërkesave që ka lënë edhe vetë KLSH-ja lidhur me përlllogaritjen e saktë dhe pasqyrimin e saktë të deficitit buxhetor mbi limitin, por gjithsesi lidhej me problematikën e detyrimeve të prapambetura. Kështu që do të doja të dija, nëse ka ndonjë të re, apo ka ndonjë ndryshim apo për çfarë flet KLSH-ja, meqenëse ju thatë që janë përfshirë detyrimet. Pra, cili është ngërçi ose paqartësia?

Arben Ahmetaj – Zonja Denaj.

Anila Denaj – Kur flasim për treguesit, treguesit në një pasqyrë fiskale janë për konsumim të të gjitha palëve. Sigurisht, në asnjë moment Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka reshtur së bërë transparencën për të gjitha detyrimet, sikurse edhe për treguesit fiskalë. Në këtë aspekt trajtimi i detyrimeve të prapambetura, si një zë jashtë trajtimit të deklarimit të deficitit, mbi të gjitha edhe në marrëdhënie të të gjitha konsolidimeve fiskale të realizuara edhe me ekipet e FMN-së, është një proces, i cili na obligon për të parë detyrimet e prapambetura dhe për t'i adresuar ato, për t'i ulur dhe zvogëluar, gjë që Ministria e Financave është duke e bërë.

Ne trajtuam dje detyrimet e prapambetura në të tre komponentët tij, si në aspekt të qasjes se kush paguhet e para, para projekteve të tjera, ashtu edhe në deklaratimet se cilat janë detyrimet e prapambetura, sikurse edhe në publikimet, por nuk ka qenë dhe nuk është një detyrim i vendosjes së tyre në këto tregues fiskalë, siç e përmendi pak më parë zonja deputete. Në asnjë moment nuk është rreshtur së bërë transparencë për detyrimet e prapambetura.

Arben Ahmetaj – Unë do të bëj një koment shtesë. Praktikisht kur mbyllet deficit i buxhetor, le të themi në datën 15 janar ose më 19 janar, që është mbyllur në vitin 2019 i vitit 2018, Ministria e Financave ka detyrim ligjor të shohë çfarë është sjellë si faturë atë ditë, që ka të bëjë me shpenzimet e vitit 2018. Është përveç të tjerave, edhe një *snap shop*, i atij momenti.

Ndërkohë, po të shohim tabelat fiskale që ndan qeveria me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka konceptin e borxhit neto dhe borxhit bruto, që do të thotë në funksion të asaj që tha edhe ministrja, të gjitha shifrat janë transparente. Po të shohim, Ministria e Financave flet për borxhin neto kur flet me FMN-në dhe ka mbi tre vjet që Ministria e Financave me iniciativën e vet bën transparente detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor, TAP-in, që është rimbursimi i TVSH-së, Trans Adriatik Pay Plan që ka ardhur menjëherë si detyrim dhe, po qe se i referohemi asaj që diskutuam dje, edhe shumës që ka Ministria e Infrastrukturës ose në tërësi qeveria. Pra, jemi duke folur për transparencë të plotë 100%. Deficiti buxhetor është brenda vitit fiskal.

Faleminderit!

A ka pyetje tjetër? Po, Landi.

Ronlant Xhelilaj– Faleminderit!

Unë kam një pyetje që lidhet me normat e interesit në menaxhimin e borxhit publik. Eliminimi i një risku është të ulet pesha e borxhit që maturohet brenda vitit dhe titujve që kanë norma interesi të ndryshme. Unë dua të di, a ndikon kjo në uljen e mundësive për të marrë borxhe nga tregu i brendshëm? Norma e interesit e ulët dhe eliminimi i mundësisë për maturim brenda vitit a ndikon apo ka interes më shumë për kohëzgjatjen e tij 3 ose 5 vjeçare, sipas politikës që ju përcaktojnë?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre.

Anila Denaj - Dy elemente të rëndësishme janë kur flasim për borxhin. Së pari edhe në fjalën time unë thashë se pjesa e borxhit të brendshëm ka një përqindje më të lartë se sa borxhi i jashtëm dhe, së dyti, është shtrirja në vite e ndryshimit të maturitetit. Unë po e them me shifra, nga viti 2015 deri në vitin 2019 maturimi ka ardhur duke u ulur duke përfaqësuar aktualisht 34% nga 43 % që ka qenë më parë dhe duke e shtuar përqindjen e maturimit afatmesëm dhe afatgjatë deri në 10 vjet. Respektivisht shifrat shkojnë nga 18,6 % dhe 24,6% për maturitete mbi një vit.

Arben Ahmetaj– 857 ditë nga 500 ditë është zgjatur maturiteti mesatar, po shkon në 900 në ditë avash-avash, dhe ildi mesatar ka rënë nga 7,2 në 3,2. Pra, tregon menaxhimin që i ka bërë Ministria e Financave borxhit në vite.

Anila Denaj– Menaxhimi nuk është vetëm me normën e interesit, sepse është e rëndësishme që norma e interesit sigurisht është në kosto financiare, por edhe menaxhimin e risqeve në momente të caktuara të presionit kohë për likuiditet.

Konkretisht, nëse flasim për emetime, të cilat kanë të bëjnë në terma bruto nga një vit në tjetrin, këto janë ulur, sikurse dhe maturimet dhe rifinancimet. Kjo falë kësaj zgjatjeje nga 387,8 në 283 në vitin 2019. Pra, edhe presioni vjetor për maturime ka ardhur duke u ulur dhe ky është një eliminim risku, përtej eliminimit që vjen si rezultat i tregjeve lokale njëkohësisht.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Kushi.

Evis Kushi - Faleminderit!

Kur hartohet buxheti i vitit pasardhës, gjithmonë ka disa rregulla dhe parime fiskale që duhet të respektohen. Një nga këto parime është edhe ai parim sipas të cilit masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit. Sa është respektuar ky parim, rrjedhimisht sa është balanca korrente e targetuar për vitin e ardhshëm?

Faleminderit!

Endrit Lami – Bëhet fjalë për rregullin fiskal, që i vë dysheme balancës korrente, ose siç njihet ndryshe rregulli i artë i buxhetit. Ky është një nga rregullat më të përmbushur dhe ka qenë historikisht i tillë në çdo qeverisje. Ajo çka ka ndodhur vitet e fundit, ka qenë se kjo balancë korrente ka qenë akoma më pozitive. Në vitin 2018 ishte kulmi, 3.2 dhe këtë vit është pothuajse në atë nivel, që do të thotë se niveli i shpenzimeve kapitale si përqindje e produktit të brendshëm bruto është 3 % më i lartë se deficitin ose huamarrja neto vjetore.

Evis Kushi - E bëra pyetjen, sepse një nga arritjet më të mëdha që ka pasur projektbuxheti gjatë këtyre viteve të fundit të qeverisjes sonë ka qenë pikërisht kjo, balanca korrente pozitive, madje pas shumë vitesh, për herë të parë ishte në nivele shumë të larta. Ndaj, doja të dija, a jemi ende në këtë trend, sepse është një nga treguesit më të rëndësishëm?

Arben Ahmetaj – Balanca korrente është një logjikë cilësore e referuar si rregulli i artë i asaj që ti merr borxh dhe për çfarë e përdor, në thelb.

E dyta, por besoj që ti iu referove edhe asaj tjetrës, është balanca primare. Kjo presupozon përgjegjshmërinë e një qeverie në raport me menaxhimin e financave publike në tërësi dhe borxhit publik. Kur balanca primare është pozitive, tregon se një qeveri është e përgjegjshme, vjen në parlament dhe i thotë parlamentit: “Unë me operacionet e mia korrente nuk do të krijoj borxh të ri, por përkundrazi do t’i shërbej borxhit që kam trashëguar”. Balanca primare është pozitive duke

filluar që nga vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019. Balanca korrekte është një element, ne i referohemi si rregulli i artë, por është cilësi e buxhetit. Është një raport që e kemi prodhuar që në vitin 2017 “Huamarrje me investime”, që po ta shohësh është përmirësuar ndër vite nga 100 lekë në 118, pastaj 170 lekë, 200 lekë, 230 dhe 270 lekë në fund. Pra, ka të bëjë me cilësinë e kuadrit makro, ti vërtetë e mban, por e mban edhe me cilësi. Ky është thelbi.

Ka ndonjë pyetje tjetër? S’ka pyetje të tjera.

Unë e mbajta qëndrimin tim, nuk do të bëj pyetje. Qëndrimi në finale fokusohet te menaxhimi i borxhit, i deficitit dhe i borxhit publik. Tashmë ka një traditë të konsoliduar brenda qeverisë “Rama” për reduktimin e borxhit. Ministrja iu referua uljes graduale të borxhit publik dhe menaxhimit të detyrimeve të prapambetura në kuadrin e vënies së tyre primare për t’u shlyer duke pasur balancën e kujdesshme midis hapjes së projekteve të reja dhe shlyerjes së projekteve në vazhdim.

Edhe vitin tjetër borxhi publik do të shkojë në rënie me një deficit të shëndetshëm prej 1.6 % të prodhimit të brendshëm bruto, me balancën korrente gati 3% që është në nivele shumë të shëndetshme, me balancën primare gjithashtu të referuar shumë të shëndetshme prej 0.6 %. Ndërkohë, edhe kombinimi midis borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm ka vite që menaxhohet në drejtimin e shëndetshëm. Në të njëjtën kohë, brenda borxhit, cilësia e tij me maturimin afatgjatë, që është në ditë zgjatje gati 900 ditë, ndërkohë që ka qenë 470 ditë, 500 ditë dhe erdhi duke u zgjatur illdi mesatar në rënie. Sigurisht që qeveria dhe Ministria e Financave duhen të kenë kujdes se ndër këto vite do të fillojë të reduktohet gjithë borxhi koncesionar dhe të zëvendësohet me borxh komercial. Këtu që do të duhet të mbështesim Ministrinë e Financave për strukturën e menaxhimit të borxhit. Ministrja jonë sërish mendoj Drejtoria e Borxhit duhet të forcohet. Unë jam gati që ta diskutoj me komisionin të shtojmë numra nëse ju bini dakord me Kryeministrin. Besoj që edhe brenda buxhetit tuaj të vendosim një fond të posaçëm për trajnimin e departamentit. Nëse doni, ne mund t’ju mbështesim edhe për një përjashtim të drejtorit të Përgjithshëm të Borxhit ose të dy drejtorëve, drejtori i nivelit II dhe I, për shkak se është shumë e vështirë për të gjetur persona, të pezullohet për një periudhë prej 5 vjetësh marrja nga administrata publike dhe ju të keni mundësi të bëni *head hunting* dhe të bëni përzgjedhje nga sistemi bankar apo kudo qoftë. Brenda fondit mund të ketë edhe bonus. Unë e kam provuar vetë sa e vështirë është me strukturën aktuale, i njoh të dy përfaqësuesit që keni, ata kanë bërë një punë të shkëlqyer. Kështu që, nëse ju vendosni që të ecni në këtë drejtim, ne jemi gati t’ju mbështesim. Unë e besoj që Departamenti i Borxhit sot do

të duhet të jetë shtyllë më vete nën drejtimin tuaj. Kështu që gjykoheni, më thoni dhe unë jam gati ta bëj si propozim vetë, madje ta trajtojmë edhe si grup ekselence nëse doni.

Këto janë ato që doja të thosha. Ju falënderoj për punën në lidhje me menaxhimin e borxhit publik!

Në qoftë se nuk ka ndonjë qëndrim tjetër, do ta konsideroja mbledhjen të mbyllur.

Do të doja t'i uroja ministres dhe stafit punë të mbarë sot!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti